

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në pozicionin “Specialist IT”:**

**Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Specialist IT” në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të kenë përfunduar studimet e larta së paku në nivelin “Master Profesional”, në njërin prej fushave të Inxhinierisë Informatike, Inxhinierisë Elektronike, Inxhinierisë së Telekomunikacionit dhe Informatikë;
2. Të ketë eksperiencë pune në fusha të ngjashme.

**II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me karakter akademik në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në pozicionin e “Laborant” pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit:**

**A. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin e “Laborantit” pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” ose “Master Profesional” në programin/et e studimit “Inxhinieri Materiale” dhe/ose “Inxhinieri Mekanike”;
2. Kandidatët duhet të kenë notë mesatare të dy cikleve të studimit (3+2) mbi 7 (shtatë);
3. Kandidatët duhet të kenë njohuri në pajisjet laboratorike, si dhe në fushat e kërkimit shkencor dhe të karakterizimit të materialeve inxhinierike veçanërisht: *të ketë njohuri në përdorimin e mikroskopisë optike, të ketë njohuri për vlerësimin dhe provat e vetive mekanike të materialeve inxhinierike; të shoqëruara me vërtetim për zbatueshmërinë e provave pa shkatërrim;*
4. Preferohet të ketë eksperiencë mbi 2 vite, si dhe të ketë njohuri për teknikat e avancuara të provave dhe analizave të materialeve;
5. Preferohen kandidatët me njohuri mbi standardet ndërkombëtare. Aftësi dhe zbatueshmëri për standardin ISO 17025 (laborator testues dhe kalibrues);
6. Të njohin gjuhën angleze;
7. Të kenë aftësi të mira bashkëpunuese dhe komunikuese me personelin akademik dhe ndihmësakademik.

**III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **13.07.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.